VENDIM
Nr. 229, datë 19.7.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALB SUN ENERGY" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a" dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1892/1 prot., datë 14.7.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Alb Sun Energy' sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Bashkinë Fier",

konstatoi se:

- Shoqëria "Alb Sun Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1892 prot., datë 7.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria "Alb Sun Energy" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a" dhe "d"; për pikën 1.3, germat "a", "b" dhe "c", si dhe pikën 2.1, germat "c", "d", "e" dhe "f".

- Nga ky aplikim, gjithashtu, rezulton se duhet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, "Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë"

Pika 1.2, "Dokumentacioni juridik dhe administrativ"

- Germa "b": Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (Dëshminë e penalitetit), lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë "Alb Sun Energy" sh.p.k.

- Germa "c": Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE strukturën organizative, ku të jetë përfshirë dhe stafi teknik, referuar veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 2, "Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës"

Pika 2.1. Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- Germa "a": shtojcën 2 të plotësuar.

- Germa "b": kontratën përkatëse të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE-n) për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit fotovoltaik.

- Për dokumentacionin e plotësuar pjesërisht do të njoftohet aplikuesi që të bëjë plotësimin e tij, brenda afatit të përcaktuar në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien,

modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Alb Sun Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Alb Sun Energy" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti